

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale,**  
**mbajtur më 27.2.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, mr. Metodija Jançeski, dr.Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** dr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Arben Saiti, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave - kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.2.2023 .
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 23.2.2023.
3. Raport për llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 me Propozim-vendim për miratimin e llogarisë vjetore.
4. Propozim-vendim për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet RRPKE që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel rajonal.
5. Propozim për dhënie miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbim: telefona celularë.
6. Propozim për dhënie miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtja e higjienës.
7. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e vazhdimit të parë të seancës së 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.2.2023, me tekstin e propozuar .

## **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 7-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 23.2.2023, me tekstin e propozuar.

## **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin për llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022 me Propozim-vendim për miratimin e llogarisë vjetore. Ai shpjegoi se Agjencia në pajtim me Ligjin për Kontabilitet të Organizatave Jofitimprurëse, e dorëzon llogarinë vjetore për vitin paraprak, jo më vonë se 28 shkurti i vitit aktual. Të ardhurat (hyrat) totale të realizuara në vitin 2022 arrijnë në 84.020.798,00 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave, gjegjësisht 54.430.568,00 denarë, që paraqet 64,78% nga të ardhurat (hyrat) totale, janë për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë (d.m.th. 54.000.000,00 denarë) dhe taksa (tarifa) e mbledhur nga vitet e kaluara në shumë prej 430.568,00 denarë. Financimi mbi bazën e deklaruar dhe në vitin 2022 është gjithashtu në përqindje më të ulët se ajo e përcaktuar në Ligj dhe është 0,412% e të ardhurave në vitin 2021, në vend të 1%. Të ardhura prej 17.931.404,00 denarë janë realizuar nga lejet për kryerjen e veprimtarive radiodifuzive, ndërsa të ardhura prej 17.931.404,00 denarë janë realizuar nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore dhe shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës janë realizuar të ardhura prej 10.525.447,00 denarë. Pjesa tjetër e të ardhurave është realizuar nga fatura tranzit në shumën prej 1.047.263,00 denarë nga Agjencia për Rini dhe Sport dhe Ndërmarrja Publike për menaxhimin e hapësirës banesore dhe afariste si dhe të ardhurat e tjera në shumë prej 77.195,00 denarë, gjegjësisht të ardhurat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për aktivitete zgjedhore të zhvilluara në vitin 2021 në shumë (vlerë) prej 7.962,00 denarë dhe prej diferenca pozitive të kursit të këmbimit në shumë prej 959,00 denarë. Shpenzimet e përgjithshme të realizuara në vitin 2022 arrijnë në 94.601.988,00 denarë. Shpenzimet më të mëdha janë për pagesën e pagave bruto të të punësuarve në shërbimin profesional, në vlerë prej 51.194.894,00 denarë, që paraqet 54,11% të totalit të shpenzimeve. Shpenzimet tjera më të mëdha kanë të bëjnë me kompenzimet për anëtarët e Këshillit të Agjencisë në shumë prej 9.020.301,00 denarë, për servisim dhe mirëmbajtje të pasurisë së Agjencisë në shumë prej 8.267.410,00 denarë, shpenzime për energji elektrike dhe termike të konsumuar në shumë prej 4.840,00 denarë, shpenzime për punësim të bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm, për servisim dhe mirëmbajtjen e mjeteve të Agjencisë në shumë prej 8.267.410,00 denarë, shpenzime për energjinë e harxhuar dhe për ngrohje në shumë prej 4.841.756,00 denarë, shpenzime për punësim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nëpërmjet Agjencisë për punësim të përkohshëm, për angazhimin e biros (zyrës) për përkthim, për mirëmbajtjen e higjienës në ambientet zyrtare dhe për kontroll të jashtëm të TIK-ut në vlerë prej 3.989.396,00 denarë. Të gjitha shpenzimet e bëra janë më të ulëta se shpenzimet e planifikuara në pozicionet e specifikuar në Planin Financiar të miratuar për vitin 2022. Kërkesat totale të Agjencisë për Shërbime mediatike

Audio dhe Audiovizuale sipas llogarisë vjetore për vitin 2022 arrijnë në 2.880.071,00 denarë dhe më së shumti i referohen faturave të lëshuara në vitet e kaluara. Gjithsej detyrimet e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ndaj kreditorëve sipas llogarisë vjetore për vitin 2022 janë 1.982.267,00 denarë. Këto borxhe i referohen detyrimeve të papaguara (mbetura), të cilat janë paguar kryesisht në janar 2023. Vlera kontabël e mjeteve bazë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në fund të vitit 2022 është 298.632.286,00 denarë. Në vitin e ardhshëm 2023, në llogarinë vjetore do të transferohen mjete në vlerë të përgjithshme prej 142.648.344,00 denarë. Diferenca prej rreth 10 milionë denarë nga shpenzimet më të larta në raport me të ardhurat (hyrat) vjen si pasojë e donacionit që Agjencia ua ka dhënë transmetuesve në vlerë prej 50% të kompensimit për lejet që duhet të paguajnë për transmetimin në televizion dhe radio dhe në thelb arriti në 19 milionë e 500 mijë denarë. Po të mos ishte donacioni, Agjencia do të ishte rreth 9 milionë denarë në plus, pa marrë parasysh se nga Buxheti i RMV-së në llogarinë e Agjencisë janë transferuar gati 58% më pak mjete.

Z. Fidanoski tha se nga shifrat e dhëna në material në lidhje me shpenzimet që ka pasur tregojnë se ASHMA-ja ka punuar si amvisë e mirë gjatë vitit të kaluar. Të gjitha pikat tregojnë se është shpenzuar më pak se sa pritej. Ajo që veçanërisht e gëzon është pika për energjinë elektrike, për të cilin vitin e kaluar u ndryshua Plani Financiar dhe u parashikua një shumë më e madhe, e cila më pas doli të jetë më e vogël, megjithëse është çështje që nuk varet tërësisht nga Agjencia, por edhe nga çmimet e energjisë elektrike në bursë. Ajo që nuk është e mirë në gjithë këtë pasqyrë dhe vazhdon të lihet pas dore në vazhdimësi është se Agjencia nuk i merr në tërësi mjetet që janë paraparë me ligj nga Buxheti, dhe për të cilat mjete hendeku rritet çdo vit. Është llogaritur se për vitin e kaluar është dashur të pranohen rreth 130 milionë denarë. Nëse shikoni donacionin që u është dhënë transmetuesve 50% më pak nga kompensimi vjetor për leje, me harxhimet totale, pjesa tjetër është praktikisht si 100% duke i përjashtuar të gjithë transmetuesit nga pagesa e kompensimit, atë diferencë nga ajo që duhet të ishte marrë dhe shpenzimet që bëjnë vitin e kaluar tregojnë se sa i madh është ai hendek. Këtë vit ai numër duhet të jetë edhe më i madh, nëse do të realizohet apo jo ende nuk dihet, të shpresojmë se do të realizohet, por vazhdimësia thotë se duhet të jenë skeptikë. Në fund, ai deklaroi se do të mbështesë miratimin e Raportit.

Z. Trajçevski, proceduralisht, tha se dallimi prej 84 milionë denarë në 130 milionë denarë është për shkak se këtu janë shtuar vetëm 54 milionë denarë të marra nga Qeveria, pjesa tjetër është nga të ardhurat (hyrat) e tjera të realizuara nga Agjencia, pra diferenca është 80 milionë denarë. Nëse shuma e përgjithshme merret nga Qeveria dhe me të ardhurat (hyrat) e tjera që i realizon Agjencia, atëherë të hyrat e përgjithshme të ASHMA-së do të ishin 179 milionë denarë, pra në atë rast do të kishte në fund të vitit 80 milionë denarë tepriçë të mjeteve.

Z. Fidanoski tha se plotësisht pajtohet me drejtorin. Ai ka shpjeguar se ka dashur vetëm të bëjë një "matematikë zbavitëse" për këto dy pika (pozicione) se diferenca mes këtyre të dyjave mjafton për një përjashtim 100% dhe nuk është e diskutueshme që bashkë me të ardhurat e tjera që Agjencia ka nga operatorët, faturat tranzite, detyrimet e vonuara të taksës radiodifuzive, arrijnë në rreth 3 milionë euro në denarë. Këtë vit duhet të jetë mbi 150 milionë denarë sipas projeksionit buxhetor, nëse respektohet 6%.

Z. Ajdini tha se ashtu siç janë mësuar nga vitet e kaluara, Agjencia edhe vitin e kaluar ka punuar si amvisë e mirë. Dhe përkundër faktit se ASHMA-ja është dashur t'i marrë mjetet nga Buxheti i RMV-së në tërësi dhe me donacion e shpërndarë shihet se gjendja financiare

e Agjencisë është stabile, që do të thotë se dhe më tej do të vazhdojë të punojë dhe të përmbushë detyrimet ligjore. Ai deklaroi se do të japë mbështetje.

Z. Petrushevski tha gjithashtu se do të mbështesë Raportin Vjetor të Llogarisë së Agjencisë

Këshilli i Agjencisë pranoi Raportin e llogarisë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 Nr. 05-849/1 datë 23.2.2023 dhe njëzëri miratoi Vendim për miratimin e llogarisë vjetore të Agjencisë për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Kontabilitetin e Organizatave Jofitimprurëse, llogaria vjetore dorëzohet në Administratën e të Hyrave Publike dhe te Regjistri i llogarive vjetore pranë Regjistrat Qendror deri në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm .

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e lejes për transmetim televiziv përmes JRRPKE që nuk shfrytëzon resurse të kufizuar në nivel rajonal. Ai shpjegoi se propozohet që personit juridik PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup t'i jepet leja për transmetim në nivel rajonal, në territorin e Shkupit dhe komunave të përcaktuara sipas aktit nënligjor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase. Ky transmetues i ardhshëm shprehu fillimisht interesimin e tij më 31.5.2021. Më pas para se të dorëzoheshin zyrtarisht dokumentet aktuale, janë mbajtur dy takime në prani të avokatëve të shoqërisë juridike. Takimi i parë ka qenë më 11 korrik 2022, në të cilin kanë dorëzuar për mbikëqyrje (inspektim) dokumentacionin me kërkesë për dhënien e lejes. Nga mbikëqyrja u konstatua se dokumentacioni nuk është i plotë. Më pas është mbajtur takimi i radhës më 7 nëntor 2022, në të cilin dokumentacioni është dorëzuar sërish për mbikëqyrje (inspektim). Nga dokumentacioni u rezultua se disa nga vërejtjet ishin korrigjuar, por kishte ende mangësi që duheshin hequr, kështu që më 21.12.2022, parashtruesi i kërkesës sërish ka dorëzuar një shtesë. Parashtruesit të kërkesës i është dërguar Shkresë-Njoftim për mënjanimin (heqjen) e mangësive dhe është detyruar sërish që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Njoftimit, të plotësojë Kërkesën për dhënie leje pa shpallje të konkursit publik. Më 25.1.2023, parashtruesi i kërkesës, personi juridik DPTPU PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, sërish në Agjenci ka dorëzuar plotësim në Kërkesën për dhënie të lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv. Pas shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se e njëjta është e rregullt dhe e plotë. Për këtë arsye i propozohet Këshillit miratimi i këtij Vendimi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për transmetim televiziv të servisit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv - zona në nivel rajonal të Shkupit (qyteti Shkup dhe komunat Çuçer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishtë), të subjektit juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, shitje dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, me NVAS 7523602.

Shërbimi programor televizive do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs (burim) të kufizuar.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, tregti dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilës i është dhënë leja, detyrohet (obligohet) të fillon kryerjen e veprimtarisë më 1.5.2023.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike në afat prej 5 ditësh nga dita e dhënies së lejes transmetuesit në fjalë nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs (burim) të kufizuar të lidh kontratë me transmetuesin duke respektuar parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit të televizionit të ardhshëm i uroi sukses në punën e tij, veçanërisht që në këto kohë të vështira rrallë hapen media të reja kur shihet se kohëve të fundit ka pasur media që e kanë ndërprerë veprimtarinë (punën) e tyre.

## **Pika 5**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: telefoni celular. Ajo shpjegoi se kontrata që do të rezultojë do të lidhet për një periudhë prej dy vjetësh. Sipas shumës së mjeteve, furnizimi do të kryhet si procedurë e hapur e thjeshtuar, që do të thotë se shpallja për këtë furnizim do të publikohet në sistemin elektronik për furnizime publike dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Ajo tha se të gjitha të dhënat e tjera për mënyrën se si do të kryhet kjo procedurë, kushtet, afatet dhe të dhënat tjera relevante gjenden në materialin sipas pikës.

Udhëheqësi i Sektorit për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme, z. Arben Saiti, sqaroi se në lidhje me specifikimin e mëparshëm që ishte para 2 vitesh, këtë vit ka më shumë kërkesa nga operatori i ardhshëm ekonomik që do ta ofrojë (sigurojë) këtë shërbim. Aty thuhet se pika (pozicioni) për internetin është rritur në të dyja paketat. Është rritur edhe roming biseda, po ashtu edhe roming interneti, i cili tashmë ofrohet në të dyja paketat. Pakoja bazë do të ketë roming internet prej 2 GB, 50 GB internet, ndërsa pakoja më e madhe do të ketë 70 GB internet, 150 minuta bisedë jashtë vendit, 100 minuta në roaming dhe 5 GB roming internet. Ai shpjegoi se performanca nga 2 vite më parë është rritur, gjë që beson se do t'i plotësojë nevojat e Agjencisë. Në specifikacionin teknik është përfshirë që operatori ekonomik nëse ofron shërbime 5G duhet këtë t'ia ofrojë edhe Agjencisë, që do të thotë se celularët që do të blihen duhet të mbështesin edhe rrjetin 5G.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka dhënë miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizimin e shërbimit - telefona mobilë (celular).

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: telefona mobilë është e paraparë dhe është në pajtim (përputhje) me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, gjegjësisht do të parashikohen me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024.

## **Pika 6**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: mirëmbajtja e higjienës. Ajo ka shpjeguar se sipas shumës së mjeteve, furnizimi do të kryhet si procedurë e hapur e thjeshtuar, që do të thotë se shpallja për këtë furnizim do të publikohet në sistemin elektronik për furnizime publike dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së, dhe kontrata që do të rezultojë do të lidhet për periudhë prej 1 viti. Ajo tha se të gjitha të dhënat e tjera për mënyrën se si do të kryhet kjo procedurë, kushtet dhe afatet dhe të dhënat e tjera relevante gjenden në materialin sipas pikës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka dhënë miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizimin e shërbimit - mirëmbajtjen e higjienës.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: mirëmbajtja e higjienës është e paraparë dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

#### **Pika 7**

##### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-857/6**

**08.03.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**